

GJUHA SHQIPE

QELLIMET DHE DETYRAT

Elementi kryesor i identitetit individual i cili përbën një nga tiparet themelore të një kombi është gjuha. Procesi i cili asnjëherë nuk përfundon është mësimi i gjuhës, prandaj edhe kërkon përkushtim të madh, sepse ka peshë të veçantë, veçanërisht në shkollë ngase kryen funksion të dyfishtë: si lëndë kryesore mësimore dhe si gjuhë për lëndët e tjera shkollore.

Nëpërmjet të lëndës së gjuhës amtare nxënësit aftësohen të lexojnë tekste të ndryshme, të shprehin drejt dhe qartas me gojë e me shkrim në situata të ndryshme, të mësojnë si të hartojnë tregime, të tregojnë ngjarje, të argumentojnë pikëpamje, qoftë me gojë, qoftë me shkrim, të hartojnë shkrime të argumentuara dhe të marrin pjesë aktive në debate, të përdorin gjuhën e tyre amtare në përputhje me situata konkrete të komunikimit. Thelbin e mësimi të gjuhës amtare në shkollë e përbën formimi i shprehive të përdorimit të gjuhës me gojë dhe me shkrim dhe njohja e modeleve kulturore e estetike të domosdoshme për formimin e tyre kulturor.

Programi i gjuhës shqipe për klasën e pestë është konceptuar, jo vetëm si vazhdimësi e programeve të klasave paraprake, por kryesisht si konceptim e lidhje me programin e klasës së gjashtë të shkollës fillore.

Programi i gjuhës për këtë klasë është organizuar përmes këtyre shkathtësive të komunikimit : dëgjimit, të folurit, leximit dhe shkrimit brenda të cilave janë vendosur tërësitë tematike e në kuadër të tyre përmbajtjet programore dhe rezultatet e pritshme.

Nëpërmjet kësaj lënde, nxënësit pasurojnë fjalorin, mësojnë përdorimin e kategorive gramatikore nëpërmjet shkathtësive gjuhësore, rregullat kryesore të saj dhe drejtshkrimin, mësojnë si të vlerësojnë, të ndërtojnë dhe kultivojnë aftësitë e tyre për të gjykuar. Ajo i vë nxënësit në kontakt me veprat madhore të letërsisë kombëtare dhe botërore që janë në pajtueshmëri me dëshirën, kërkesën dhe moshën e tyre. Duke lexuar, nxënësit fitojnë një përfytyrim fillestar për krijimtarinë letrare dhe periudhën kohore të caktuar.

KLASA E V-të

DETYRAT OPERATIVE

Përforcimi dhe zhvillimi i njohurive të përvetësuara më parë është qëllimi kryesor i mësimit të gjuhës shqipe në klasën e gjashtë e ato janë:

Zhvillimi i shkathtësive të dëgjimit informativ dhe të dëgjuarit aktiv në grup në kuptimin e marrjes së informatave dhe të mesazheve;

Zhvillimi i kulturës dhe shkathtësive të komunikimit, komunikimin verbal e joverbal;

Zhvillimi i shkathtësive të të folurit aktiv individual e në grup në funksion të përvetësimit të gjuhës standarde dhe të thellojë njohuritë themelore gjuhësore;

Zhvillimi i shkathtësive të të shkruarit funksional dhe të shkruarit subjektiv (vetjak);

Të kuptojë dhe të dallojë të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare e të përvetësoj teknikat e leximit;

Të përvetësojë të shkruarit në funksion të përvetësimit të gjuhës, të leksikut;

Të përvetësoj të shkruarit në funksion të drejtshkrimit dhe të pikësimit.

Organizimi i përmbajtjes programore

5 orë në javë, 180 orë në vit.

OBJEKTIVAT PROGRAMORE

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë:

Tekste letrare dhe joletrare;

Fjalët e ndryshueshme e të pandryshueshme, tipat dhe llojet e fjalive;

Të kuptojë:

Tekste letrare dhe joletrare;

Fjalët e ndryshueshme dhe pandryshueshme, gjymtyrët kryesore dhe të dytat të fjalisë, fjalitë e përbëra dhe ligjëratën.

Të zbatojë:

Njohuritë e fituara gjuhësore fonetike e gramatikore;

Njohuritë e fituara mbi modelet e shkrimit;

Njohuritë e fituara mbi modelet e teksteve letrare dhe joletrare.

Të analizojë:

Takste letrare dhe joletrare;

Fjalitë e thjeshta dhe fjalitë e përbëra.

Vlerat, qëndrimet, formimi:

Të menduarit e pavarur për atë që dëgjon, shpreh, lexon dhe shkruan;

Kulturë e sjelljes personale – qëndrimi, sjellja, toleranca, mirëkuptimi;

Komunikimi, vullneti, bashkëpunimi, ndihma reciproke etj.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

Shkathësitë e komunikimit

- Të dëgjuarit
- Të folurit
- Të lexuarit
- Të shkruarit

TË DËGJUARIT

TËRËSITË TEMATIKE

1. Të dëgjuarit informativ;
2. Të dëgjuarit efektiv;
- I. 3. Të dëgjuarit e teksteve letrare dhe joletrare;
- I. 4. Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës;
- I. 5. Të dëgjuarit në funksion të zgjerimit të leksikut.

II. TË FOLURIT

TËRËSITË TEMATIKE

- II. 1. Të folurit informativ;
- II. 2. Të folurit aktiv në grup;
- II. 3. Të folurit në funksion të teksteve letrare dhe joletrare;
- II. 4. Të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës;
- II. 5. Të folurit në funksion të zgjerimit të leksikut;
- II. 6. Të folurit joverbal.

III. TË LEXUARIT

TËRËSITË TEMATIKE

- III. 1. Të lexuarit e teksteve letrare;
- III. 2. Të lexuarit e teksteve joletrare;
- III. 3. Të lexuarit në funksion të teknikave të leximit;
- III. 4. Të lexuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës;
- III. 5. Të lexuarit në funksion të zgjerimit të leksikut.

IV. TË SHKRUARIT

TËRËSITË TEMATIKE

- IV. 1. Të shkruarit funksional;
- IV. 2. Të shkruarit personal imagjativ;
- IV. 3. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të gjuhës;
- IV. 4. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të leksikut;
- IV. 5. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të drejtshkrimit;
- IV. 6. Të shkruarit në funksion të pikësimit.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët, mirëpo lidhje të drejtpërdrejta vihen me:

Edukatë muzikore;
Edukatë figurative

Edukatë qytetare ose fetare;
Punë dore,
Histori;
Gjuhë joamtare, etj.

Pesha dhe rëndësia e lidhjes ndërlëndore përbën një resurs shumë të favorshëm e ndikues në zhvillimin dhe formimin e tërësishëm të personalitetit të secilit nxënës. Mësimdhënësit duhet të punojnë sa më shumë që është e mundur në realizimin e integritit ndërlëndor, sepse është shumë e domosdoshme në këtë kohë të zhvillimit të kompjuterizimit dhe internetit.

Janë të shumta përmbajtjet dhe temat nga fushat e ndryshme që mund të trajtohen, zhvillohen dhe realizohen si pjesë ndërprogramore. Rëndësia e tyre kryesisht përcaktohet nga mundësitë e sigurimit të literaturës dhe peshës që mund të ketë mosha dhe koha e realizimit. Lidhjet ndërprogramore janë kryesisht të fushave si:

- Të drejtat e njeriut – fëmijëve;
- Edukimi shëndetësor;
- Ekologjia dhe mjedisi;
- Barazia gjinore; etj.

¶

UDHËZIME PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT

Vendin kryesor në realizimin e përmbajtjes programore e zë metodologjia e mësimdhënies. Mësimdhënësi, gjatë realizimit të procesit mësimor duhet të ketë parasysh strategjinë më efektive, të cilat e mundësojnë mësimin efektiv. Për nxënësit, mësimdhënësi duhet të jetë model në mënyrën e përdorimit të shkathtësive gjuhësore dhe njëherit vëmendja e tij duhet të përqendrohet në disa parime bazë:

Përqëndrimi në komunikimin (shkathtësitë e komunikimit) dhe përqëndrimi në gjuhën e gramatizuar;

Përqëndrimi në nxënësin dhe të nxënësit e tij. Në qendër të vëmendje duhet të jetë nxënësi. Karakterin, përparësitë dhe dobësitë e nxënësit mësuesi duhet të bëjë përpjekje që t'i njohë mirë, ta verifikojë a është tip i mbyllur a i hapur, frikacak apo guximtarë, a merr vetë iniciativa apo duhet të nxitet nga mësuesi etj.

Roli i mësimdhënësit është rol vendimtarë që do të ndihmonte në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Kjo do të varet nga planifikimi i orës mësimore: përdorimi i hapësirës në klasë, d.m.th. mënyra e vendosjes së bankave si dhe aktivitetet që zhvillohen në klasë: mënyra e komunikimit, luajtja e roleve, puna në grupe etj.

VLERËSIMI

Vlerësimi ka për qëllim verifikimin se në ç'skallë kanë zotëruar nxënësit objektivat e përcaktuara, të identifikojë vështirësitë me të cilat ballafaqohen nxënësit, t'u mundësohet atyre që t'i identifikojnë përparësitë dhe pengesat, si dhe t'u ndihmohet nxënësve në përmirësimin e pikave të dobëta.

Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç'skallë kanë zotëruar nxënësit fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t'i përdorë shkathhtësitë gjuhësore;

Pengesat e nxënësve: vlerësohet shkalla e zotërimit të njohurive me qëllim të eliminimit të pengesave dhe të ndihmës së nxënësve për eliminimin e vështirësive;

Integrimin e njohurive të fituara: vlerësohen aktivitete apo projektet e ndryshme që nxënësit realizojnë jashtë programit shkollor dhe integrimin e këtyre njohurive në situata brenda shkollës.

Gjatë procesit mësimor rëndësi të veçantë do të kenë mënyrat e ndryshme të vlerësimit si:

Vlerësimi nga mësimdhënësi; vlerësimi i drejtpërdrejtë dhe i pandërprerë, përcjellja e vazhdueshme e rezultateve të nxënësve si dhe vlerësimi indirekt me anë të testeve;

Vlerësimi nga nxënësi; gjatë punës në grupe ose gjatë përgjigjeve që japin, nxënësit mund të plotësojnë njëri-tjetrin dhe njëkohësisht vlerësojnë mbi bazën e argumenteve;

Vetëvlerësimi; vlerësimi i vetë nxënësit.

Rëndësi të veçantë gjatë vlerësimit duhet t'i kushtojmë të shprehurit me gojë në vazhdimësi, të shprehurit gojor përmes ndërveprimit si dhe të shprehurit me shkrim:

Të shprehurit gojor për ngjarje, tregime, shpjegime;

Pyetjet dhe përgjigjet;

Iniciativat;

Mendimet e pavarura;

Shqiptimin e fjalëve;

Aktivitete brenda punës në grup;

Radhitja e fjalëve në fjali;

Fjalori (leksiku).

Vërejtje: Arsimtari mund të bëjë zgjedhjen e literaturës shtesë për realizimin e programit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

I. TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT

I. Kulturë e të folurit praktikë gjuhësore

Vetja dhe të tjerët, jeta në klasë, në shkollë, në shtëpi, në rreth etj.;

Të folurit për informacione të marra nga: mediat (televizioni, radio), shoqëria, interneti etj. ;

Përshkrime, tregime, shpjegime, përmbledhje, lutje, qortime, këshilla, përshtypje, shqetësime dhe dëshira;

II. Tekstet letrare dhe joletrare

Regjistrat e gjuhës;

Analizë e teksteve me karakter edukativ dhe shëndetësor; identifikimi i formave teksture: poezi, prozë, tekst dramatik.;

III. Zhvillimi i gjuhës

Të folurit për veten, familjen, rrethin, dikur dhe sot. Praktikimi i përdorimit të foljeve në kohë, në kontekstet e temave përkatëse; përdorimi i drejtë i përemrave; përdorimi i drejtë i tipave kryesore të fjalive;

Gjuha standarde dhe dialektore;

IV. Kulturë e të lexuarit

Leximi me zë- artistik (pjesëmarrja në role, recitim, komedi);

Ideja kryesore dhe detajet (lidhjet asociative, krahasimet, kontrastet), zhanret dhe kategoritë letrare: subjekti, kompozicioni, tema, komedia, tragjedia, komentim i teksteve;

V. Zhvillimi i gjuhës

Edukatë shëndetësore, të drejtat e njeriut, barazi gjinore;

Intonacioni në përputhje me shenjat e pikësimit;

Fjalja e thjeshtë dhe fjalia e përbërë;

Parashtesat, prapashtesat dhe mbaresat;

Kohët e thjeshta dhe të përbëra të foljeve dhe kategoritë e tjera të saj- analizë gjuhësore;

Vetja dhe të tjerët, nevojat dhe interesat e tyre, biografia dhe autobiografia, shoqëria jonë dikur dhe sot, njoftime, ftesa, falënderime, urime, përmbledhje, tregime, vjersha, pjesë humoristike, raporte, përshtypje, preferencat;

II. KULTURË E TË SHKRUARIT

I . Kulturë e të shkruarit/ të shkruarit individual

- Ese, raporte, kërkesa, komente, shkrimi deskriptiv (përshkrues), shprehjet e figurshme dhe frazeologjike(kuptimi I parë dhe I figurshëm);
- Rregullat morfologjike, sintaksore dhe leksikore;
- Fjalë foljore dhe jofoljore;
- Tipat kryesore të fjalëve (dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, thirrmore) dhe format e tyre (pohore, mohore); fjalitë e pavarura kryesore dhe të varura;
- Kryefjala, kallëzuesori i kryefjalës, kundrinori (i drejtë, i zhdrejtë, i zhdrejtë me parafjalë);
- Rrethanori (i vendit, i kohës, i shkakut) si dhe përcaktori dhe ndajshkrimi;
- Emri, mbiemri, përemrat vetorë, pyetës, lidhorë, të pacaktuar;
- Format veprorë dhe joveprorë të foljeve; foljet e zgjedhimit të parë e të dytë në mënyrën dëftore, lidhore, habitore, kushtore e urdhërore;
- Formimi i fjalëve të prejardhura(parashtesë, prapashtesë, rrënjë) dhe të përbëra; sinonimet, antonimet.